

== Përmbajtja ==

- 2 Letra ngushëlluese për Presidentin Rugova
- 2 Ndahet nga jeta aktivistja Feride Dërvishi
- 2 Shënime nga takimi i RRGK-së në Shkurt
- 3 Fahri Buçinca - luftëtar i arsimit
- 3 Kodi i Mirësjelljes (vazhdimi nga fq.1)
- 3 Shënime nga mbledhja vjetore e RRGK-së
- 4 Kvinna till Kvinna avokon për Rezolutën 1325
- 4 Njoftime të Shkurtera

== Njoftimet ==

Gratë protestojnë për mospërfshirjen e tyre në negociata.....**Teatri Kombëtar, Prishtinë, 12:00, 8 Mars**

Takimi i RRGK-së.....**ATRRC, 11:00, 3 Prill**

Konferenca për Rezolutën 1325, Prishtinë.....**Mars / Prill**

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS



KOSOVA WOMENS NETWORK

www.womensnetwork.org

RRGGK përpilon strategjitë për vitin 2006

Në Dhjetor 2005, në mbledhjen vjetore të Rrjetit, pjsëmarrësit u ndanë në grupe punuese ku u diskutua plani strategjik i Rrjetit për vitin 2006. Tri grupet punuese adresuan këto tema: fuqizimin e Rrjetit, fuqizimin politik të grave dhe avokimin për të drejtat e gruas. Grupet prezantuan rekomandimet në vijim:

1. Rekomandimet për Fuqizimin e Rrjetit

o Të prezantohen më tepër informata për punën e anëtarëve të rrjetit në vendet e rajonit, duke përfshirë edhe web faqen e RRGK-së

o Të organizohen vizita në terren për grumbullimin e informatave lidhur me punën e organizatave anëtare të Rrjetit
o Shkëmbimi i informatave gjatë këtyre vizitave.

o "One World" ofroj përkrahje për anëtar të Rrjetit duke mundësuar: shfrytëzimin e matrikëve të tyre për promovim të organizatave, trajnime në shfrytëz-

imin e teknologjisë dhe përgatitjen e materialeve për maredhënie me publikun.

o Bashkëpunim më i ngushtë me media, sidomos me radio stacionet lokale, për të pasur qasje në numër sa më të madh të grave në vende të ndryshme.

o Bashkëpunim i ngushtë me zyrtarët komunal për çështje gjinore.
o Bashkëpunim me rrjetet e grupeve të grave në rajon.

2. Fuqizimi politik i grave

o Krijimi i një grupi punues për këtë çështje mbrenda RRGK-së.
o Riaktivizimi i 30 grupeve komunale avokuese të grave.

o Anëtarët e RRGK-së të punojnë vazhdimisht në ngritjen e vetëdijes së grave për sistemin zgjedhor.

o Krijimi dhe distribuimi i udhëzuesëve për gratë votuese.

o Rritja e komunikimit mes grave politikane dhe grave votuese jo vetëm gjatë fushatave zgjedhore, përmes: 1) ngritja e vetëdijes së grave politikane mbi

Rezolutën 1325 e KSKB dhe 2) puna me gratë votuese.

o Grupi punues i RRGK-së (shih rekomandimin e parë) të takohet me qeveritarë, KB dhe grupin e kontaktit.

o Organizimi i një kofernce rajonale në pranverë dhe një koferencë ndërkombëtare në vjeshtë të 2006-tës, lidhur me Rezolutën 1325 të KSKB.

3. Avokimi për të drejtat e grave

o Avokimi për Ligjin mbi ndërprejen e shtatëzaniësë, i cili është momentalisht duke u shqyrtuar, duke: 1) kontaktuar grupin punues i cili ka përpiluar ligjin në fjalë; 2) dërgimi i draftit të ligjit Norma-së për shqyrtim ligjor; 3) organizimi i një tryeze të rumbullakët me ekspert të fushave të ndryshme, shoqërisë civile, përfaqësuese të kryeministrisë, për të diskutuar ligjin

o Organizimi i fushates kundër kancerit të gjirit duke: 1) avokuar në qeveri për ofrimin e kontrollës vjetor falas për të gjitha gratë e grup moshave të caktuara; 2) sigurimi i aparaturave të duhura për këto kontrollera në të gjitha komunat e Kosovës (tani të gjithë pacientët referohen në Prishtinë); 3) ngritja e vetëdijes mes grave për shëndetin e tyre, me theks në rrezikun prej kancerit të gjirit.

o Organizimi i fushatës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, me theks në gra dhe fëmijë përmes: 1) fushatë vetëdijësimi për këtë problematikë me shëndetësor në nxënës të shkollave të mesme; 2) fushatë mediale; 3) tryeza të rumbullakëta; 4) bashkëpunim i ngushtë me institucionet qeveritare, policinë dhe KFOR-in.



Anëtarët e Rrjetit duke punuar për strategjitë për vitin 2006 gjatë mbledhjes vjetore që u mbajt në "Hani i dy Robertëve".

RRGGK-ja harton Kodin e Mirësjelljes

Në shkurt RRGK filloi përpjekjet për hartimin e kodit të mirësjelljes për anëtarët e saj, të quajtur Kodi Etik dhe Përgjegjës. Pas miratimit nga Bordi, kodi do të shpërndahej anëtarëve të cilat vullnetarisht do të pajtohen

ta zbatojnë kodin, për anëtarësi në rrjet. Anëtarët do të kalojnë një proces verifikimi vjetor, për të siguruar që ato vazhdojnë ta zbatojnë kodin.

Ç'është Kodi i Mirësjelljes?

Kodi i Mirësjelljes është një marrëveshje në mes të organizatave, ku ato si OJO bien dakord të mbanjnë vetveten të përgjegjshme për një përmbledhje vlerash.

Vazhdon në fq. 3

Shënime nga takimi i Shkurtit

Takimi filloi me një minut heshtje për Presidentin Rugova dhe u lexua letra e ngushëllimit në emër të shoqërisë civile.

o Bordi i RRGK-së ka shqyrtuar rekomadimet për punën e rrjetit gjatë 2005 dhe për 2006.

o Anëtarët e rrjetit formuan dy grupe punuese për planin strategjik 2006 (shih fq. 1).

o RRGK po harton Kodin e Mirësjelljes për anëtarët (fq.1).

o QMVPT dhuroi kondoma organizatave që merren me shtatëzanin e hershme dhe planifikim familjar.

o Policia e UNMIK-ut njohtoi bashkëpunimin në mes të RRGK, Shërbimit Policor të Kosovës, KFOR-it dhe UNIFEM-it për implementimin e Rezolutës 1325.

o Zyra e Kryeministrit për barazi gjinore tha se pret bashkëpunim me RRGK.

o Qendra për Mirëqenien e Gruas në Pejë kërkoi ndihmë dhe përkrahje nga Rrjeti që të kërkohet përgjegjësi nga Qeveria për përkrahjen e Strehimoreve. Prej takimit që kishin me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale në korrik të vitit të kaluar nuk është marrë asnjë përgjigje.

o OJQ Violetë kërkon donator për kompjuter.

o IREX - programi për shoqëri civile, informoi anëtarët për konkursin e hapur nga IREX për mediat që të promovojnë barazinë gjinore (www.irex-kosovo.org). Poashtu informoi anëtarët për rundin e dytë të granteve që ofron FDI gjatë muajit mars (www.fdi-kosovo.org)

o Organizata e grave serbe "Lepsa Buducnosti" bëri prezantimin e aktivitetëve të tyre.

o Pas takimit, anëtarët vizituan varrin e Presidentit Rugova. RTV21 transmetoi pamjet në lajmet kryesore.

Shoqëria civile shpreh ngushëllime për vdekjen e Presidentit Rugova

Anëtarë të shoqërisë civile dërguan letër ngushlluese familjes së Presidentit Rugova dhe Presidencës.

Shoqëria civile e bashkuar sot në dhëmbjen e madhe me rastin e vdekjes së Presidentit të Kosovës, Dr. Ibrahim Rugova shpreh ngushëllimet e veta familjes Rugova, Presidencës dhe mbarë popullit në Kosovë.

Presidenti shkoi në kohën më të rëndësishme kur po vëhen themelet e një Kosove të pavarur, dëshirë kjo që të gjithë së bashku e presim me padurim të ndodh me njohjen formale të një Kosove sovranë dhe të dashur për të gjithë.

Rruga e shoqërisë civile për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe të një Kosove të pavarur e sovranë ishte e njëjtë dhe e përbashkët qysh nga fillimi i viteve '90.

Ashtu si jemi të bashkuar ne sot shoqëria civile, kërkojmë nga të gjithë faktorët politik të jenë të bashkuar dhe me një pjekuri politike e të qëndrueshme ta realizojmë se bashku amanetin e vizionarit dhe misionarit që tere jeten ia kushtoi ndertimit te shtetit te pavarur demokratik e sovran te Kosoves.

*Rrjeti i Grave te Kosoves
Lobi i Grave te Kosoves
Fondacioni per Initiative Demokratike*

*ATRC
KIPRED
Partneret Kosova-Qendra per Administrimin e konflikteve*



Me 6 Shkurt pas takimit dymujor të Rrjetit, anëtarët vizituan varrin e Presidentit Rugova.

In Memoriam

Ndahet nga jeta aktivistja Feride Dërvishi

Më 7 janar, vdiq papritmas në SHBA Feride Dërvishi. Vdekja e saj në moshën 38 vjeçare është një humbje e madhe për popullin e Kosovës, për mjekësinë e Kosovës, për pacientët e saj që aq shumë i deshi dhe u mundua gjithë jetën për ta.

Ajo ishte oligofrenologia e rrallë shqiptare e cila u përkushtua me mish e me shpirt një profesioni sa human aq edhe idealist.

Feridja ishte aktive edhe ne veprimtaritë e grave të Kosovës, emancipimi dhe të drejtat e së cilës nuk ishin në korelacion me kohën, me shoqërinë, me zhvillimin. Lufta e viteve 1998 - 1999 e gjeti në ballë të detyrës, fillimisht me të zhvendosurit nga zona e Drenicës, plagës dhe dashurisë së saj (ishte e lindur në Gradicë), në Mitrovicë e Vushtrri, por edhe në pjesët e tjera të Kosovës gjithnjë e buzëqeshur, e paprituar, e paepur në ndihmën e plagëve që po shkaktonte lufta, zhvendosja, djegiet, traumat, streset dhe fenomene të tjera që ndërli-



*Feride Dërvishi
(1967 - 2006)
ishte humaniste dhe
aktiviste që ndihmoi
shumë njerëz në kohë
të vështira.*

heshin me gjendjen e krijuar që ajo i dinte më së miri.

Bashkë me veprimtarët e shoqatës "Motrat Qiriazit" vazhdoi misionin e saj drejt pakësimit të dhimbjeve që ndiente popullata e zhvendosur me dhunë nga Kosova. Kush do ta përjetonte më rëndë një gjendje të tillë të krijuar, sesa Feridja?! Ndaj u gjend në çdo kohë dhe në çdo vend përkrah të sëmurëve, të uriturve, të stresuarve që kishin lënë shtëpitë dhe kishin çati qiellin e hapur e shtrat token e ftohtë

pranverore.

Ajo dinte t'u jepte zemër, t'i qetësonte edhe rastet më të rënda, të atyre që kishin humbur në luftë më të afërmit, prindërit apo fëmijët, vëllezërit apo motrat, të dashurin apo të dashurën.

Feridja bashkëpunoi me shumë organizata humanitare duke filluar nga UNICEF-i, Save the Children, SOROS-in, Motrat Qiriazit, OXFAM, Catholic Charities të SHBA-ve, etj.

Feride Dërvishi i lehtë të qoftë dhe i Kosovës.

Fahri Buçinca - aktivist për arsimimin e femrave

Në vitin 1993 Fahri Buçinca bashkë me të shoqën Naxhijen dhe arsimtarë të tjerë të devotshëm themeluan shoqatën "Veteranët e Arsimit" për të evidentuar e rikthyer në shkollë vajzat që kishin braktisur mësimin në rajonin e Vushtrris.

Ishin vërtet vitet e rrënimt të institucioneve dhe shkollave shqipe, prandaj arsimtarët ishin mobilizuar të organizonin mësimin nëpër shtëpi private, të cilat më vonë u quajtën shtëpi-shkolla. Shumë prindër nëpër fshatra, të hutuar nga kjo situatë, kishin humbur besimin në këtë lloj shkollimi, prandaj nuk pranonin që t'i lëshonin vajzat e tyre të ndiqnin mësimin nëpër shtëpi-shkolla. Në këtë mënyrë, pa krijoheshin analfabetë të rinj.

"Edhe pse i njihja mirë banorët e asaj ane, rrëfen prof. Fahriu, na duheshin orë e ditë të tëra të bisedonim me baballarët e fëmijëve të të dy gjinive, sidomos baballarët e vajzave, të cilat gjithsesi shiheshin si më të rrezikuara. Duheshin shumë shpjegime që prindërit të bindeshin që mosshkollimi i fëmijëve e veçanërisht i vajzave dëmtonte shumë jo vetëm ata personalisht, por edhe ardhmërinë e vendit.

"Nuk e kemi lehtë as ne, si arsimtarë të vjetër të lëvizim diku këmbë, diku me ndonjë automjet për të biseduar me ju, për t'ju bindur se dritarja, ku do ta shohim dritën e ardhmërisë është arsimimi i fëmijëve tanë".

Krahas përpjekjeve për shkollimin e vajzave shoqata "Veteranët e Arsimit" aftësoi shumë gra me kurse të rrobaqepësisë, organizoi mësimin e gjuhës an-



Fahri Buçinca tërë jetën ia kushtoi arsimimit të brezave të rinj.

gleze dhe të kompjuterëve. Hap pas hapi shumë vajza iu kthyen shkollës së mesme e duke u siguruar bursa nga donatorët vendorë vazhduan edhe fakultetin.

Tanimë shumë prej tyre kanë diplomuar dhe janë mirënjohëse. Ky sukses ishte fryt i punës së palodhshme dhe këmbëngulëse të prof. Fahriut me Naxhin, Faketën e arsimtarë të tjerë që nuk kursyen as moshën, as shëndetin, as kohën për t'u mundësuar vajzave arsimim të plotë.

Gjumnazi në Vushtrri, në ditën e shkollës shpalli prof. Fahri Buçincën dhe zonjën Naxhi "Prind të Nderit". E kush s'do t'ia dinte për nder këtij çifti që kurrë nuk rreshti duke punuar për shkollimin e gjeneratave, për

aftësimin e një brezi që do t'i shëbejë Kosovës së ardhshme.

Qëmoti prof. Fahriu ka dëshmuar se gruaja duhet të jetë e barabartë me burrin. Është një ideator e dëshmitar se si familja e lumtur funksionon, kur gruaja ka vendin që i takon, si në familje ashtu edhe në shoqëri.

Me modelin e jetës personale ata i edukuan edhe fëmijët, Xheraldinën e Gencin, ashtu po i edukojnë edhe nipërit e mbesat që të rriten në frymën e dashurisë, mirëkuptimit dhe barazisë.

Duke iu referuar thënies "E humbur është vetëm ajo, të cilës ia kthen shpinën", mund të përfundohet se prof. Fahriu akoma s'ka vendosur t'ia kthejë shpinën luftës së tij të parreshtur për shkollimin e vajzave.

Kodi i Mirësjelljes (vazhdimi nga fq. 1)

Kodi Etik dhe Përgjegjës i RRGK-së është një dokument i parimeve që përkrahë shtimin e profesionalizmit dhe efikasitetit të organizatave anëtare që punojnë në të mirë të shoqërisë.

Ai gjithashtu siguron një rrugë bashkërenditëse dhe veprim drejt barazisë gjinore dhe të drejtave të grave në Kosovë.

Pse të kemi një Kod Etik dhe Përgjegjës?

Edhe pse shumë OJQ punojnë shumë në shërbim të komu-

niteteve të tyre, disa nga OJQ-të kanë abuzuar me fonde me programet e tyre. Që puna e tyre të jetë e suksesshme, Rrjeti ka nevojë për përkrahjen e qytetarëve.

Ato gjithashtu mbështeten në përkrahje individuale, fondacione dhe organizata donatore që tu sigurojnë mbështetje morale, teknike dhe financiare.

Për këtë anëtarët e Rrjetit duhet të mbajnë marrëdhënie të besueshme dhe transparente me qytetarët si dhe me përkrahësit e

tyre.

Me qëllim që të fortësohet besimi dhe përkrahja nga shoqëria, anëtarët e Rrjetit kanë zhvilluar dhe janë pajtuar ta zbatojnë Kodin Etik dhe Përgjegjës. Kjo do tu tregoj partnerëve, qytetarëve dhe donatorëve të tyre se ato janë etike, të përgjegjshme dhe në shërbim të qytetarëve.

Shënime nga mbledhja vjetore

RRGK mbajti mbledhjen vjetore, në të cilën ishin prezent 95 pjesëmarrës: anëtare, partner dhe përkrahës të RRGK-së. Drejtoresha ekzekutive e Rrjetit prezantoi punën e Rrjetit gjatë vitit 2005 dhe shpërndau tri dhuratat për anëtarët e veta. Pjesëmarrësit diskutuan mbi strategjinë e punës për 2006-tën, bënë vlerësimin e punës së Rrjetit dhe dhanë rekomandime për punën e matujeshme dhe zgjedhën dy anëtarët e rinj të bordit.

Raporti i punës për vitin 2005

Tani rrjeti ka 81 anëtare, duke e bërë kështu rrjetin më të madh në Kosovë dhe regjion. Në vitin 2005 RRGK përbushi misionin e saj duke vazhduar punën në ngritjen e kapaciteteve; duke marr pjesë në mbledhjet lokale, regjionale dhe internacionale; duke bashkëpunuar dhe avokuar me qeverinë dhe duke bashkëpunuar ngusht me organizatat ndërkombëtare dhe donatorë për organizimin e fushatave të ndryshme.

Për informata më të hollësishme për punën e rrjetit vizitoni: <http://www.womensnetwork.org/KWN%20Reports/reports.htm>.

Strategjite për 2006

Pjesëmarrësit u ndanë në grupe punuese për të diskutuar për planin e RRGK-së për vitin 2006. (shih fq. 1)

Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Bordit

Anëtarët dhe partnerët e Rrjetit votuan dhe zgjedhën dy anëtar të rinj të Bordit të RRGK-së: aktivisten për të drejtat të grave, Marta Prekpalaj nga Prizreni / Has dhe Besim Kajtazi nga Zyra Ligjore në Ministrinë e Shërbimeve Publike.

Për më shumë informata vizitoni: www.womensnetwork.org.

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

www.womensnetwork.org

info@womensnetwork.org

Hajdar Dushi C-2, 11/8

Prishtinë, Kosovë

Stafi i RRGKK

Igballe Rogova

Drejtoresh Ekzekutive
igo@womensnetwork.org

Besa Shehu

Menaxhere e Financave
info@womensnetwork.org

Nexhmije Fetahu

Menaxhere e Programit
info@womensnetwork.org

Alba Loxha

Asistente e Informatave
info@womensnetwork.org

Bordi i RRGKK

Naxhije Buçinca

Delina Fico

Besim Kajtazi

Marta Prekpalaj

Vjosa Dobruna

Belgjyza Muharremi

Behar Selimi

"Zëri i Gruas Kosovare" është shkruar dhe dizajnuar nga Alba Loxha, me ndihmën e Nicole Fransworth

www.womensnetwork.org

Kvinna till Kvinna avokon për Rezolutën 1325

16 janar 2006 Stockholm, Sweden

Për: Të Dërguarin e Posaçëm të KB-ve për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës z. Martti Ahtisaari
Kopja për: Këshillin e Sigurimit të KB-ve Sekretarin e Përgjithshëm Kofi Annan, PSSP-në e KB-ve në Kosovë Soren Jessen-Petersen, Ministrin e Jashtëm të Suedisë Laila Freivalds

I nderuari z. Martti Ahtisaari

Fondacioni Kvinna till Kvinna mirëpret komentet e juaja me 23 nëntor në konferencën për shtyp ku thuhet se ju "do të mirëprisni pjesëmarrjen e më shumë grave në procesin" e statusit të ardhshëm të Kosovës. Në gjithashtu mirëpresim mesazhin e dhënë nga zyra juaj në Vjenë se do të ketë një bilanc të mirë gjinor në zyrë, përfshi në pozitë e nivelit të lartë, dhe se zyra do të sigurojë se udhëheqëset dhe organizatat e grave në Kosovë do të konsultohen gjatë procesit të statusit.

Deri tash Bashkësia Ndërkombëtare ka dështuar që të përbushë obligimet e saja në Kosovë të thëna në Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të KB-ve 1325: për rritjen e numrit të grave në të gjitha nivelet e vendim-marrjes në organizatat e tyre dhe që të përfshijnë gratë nga vendi në proceset e paqes. Gratë janë përjashtuar nga pothuajse të gjitha nivelet e larta brenda UNMIK-ut, KFOR-it, OSBE-së dhe IPVQ-ve dhe gratë në rajon shpesh janë përjashtuar nga proceset e rëndësishme dhe ka mungesa të mëdha në implementimin e politikave dhe ligjeve të cilat duhet të mbrojnë të drejtat e grave. Një shembull është procesi i standardeve. Edhe pse ka indikatorë të gjinisë për secilin standard kjo nuk ka shpie drejt ndryshimeve reale për gratë dhe vajzat.

Bazuar në përvojën tonë jemi shumë të brengosur se bashkësia ndërkombëtare edhe një herë ka dështuar në respektimin e të drejtave të grave për pjesëmarrje të plotë. Ka disa fakte të rrisin brengën tonë.

Nuk ka gra në delegacionin e Kosovës dhe vetëm një në atë të Serbisë. Burrat dominojnë pozitën tjera zyrtare të udhëheqjes në shoqëri. Kjo kërcënon që procesi të mos jetë korrekt, të jetë i brishtë dhe jo-demokratik.

Për më shumë bashkësia ndërkombëtare, posaçërisht SHBA-të, BE-ja dhe NATO-ja, deri më tash kanë dështuar që të emërojnë një grua në cilëndo Zyre Nderlidhëse që janë të lidhura me zyrën tuaj. Rusia ende nuk e ka publikuar emrin e Zyrarit të tyre.

Rishikimi i të Dërguarit të Posaçëm, z. Kai Eide, për situatën në Kosovë ishte një pikë fillimi për bisedimet e statusit. Sidoqoftë raporti i tij është i verbër në aspektin e gjinisë dhe nuk reflekton situatën specifike dhe sfidat me të cilat gratë dhe vajzat ballafaqohen dhe prandaj dështon që të përshkruaj situatën e vërtetë në Kosovë sot. Kjo është e rrezikshme për bisedimet e statusit pasi që rritet rreziku i përfundimeve të gabuara dhe vendimet e prioritetet e keq-informuara. Situata për gratë, gjatë vijave etnike dhe religjioze, është shumë serioze. Strukturat e fuqishme dhe të thella patriarkale, të shytyra nga rendi brenda bashkësisë ndërkombëtare, krijojnë një atmosferë e cila rrezikon statusin, sigurinë dhe pjesëmarrjen e gruas. Dhuna e burrave ndaj grave është e përhapur, posaçërisht brenda familjeve, dhe ka shumë pak përkrahje nga qeveria për gratë të cilat guxojnë që të sfidojnë normat dhe turpin dhe të raportojnë keqtrajtimit.

Zëvendësi i juaj, Albert Rohan, ka theksuar se Grupi i Kontaktit thërret të gjitha palët që të refuzojnë çfarëdo lloji të dhunës. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë dhunën më të përhapur, dhunën ndaj grave. Gjithashtu është shumë e rëndësishme që të fuqizohen gratë për t'i dhënë fund varfërisë. Nëse gratë dhe të drejtat e grave marginalizohen kurrë nuk do të ketë vetëm paqe dhe siguri të vërtetë.

Në parimet udhëzuese për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës Grupi i Kontaktit thotë se "zgjidhja e çështjes së Kosovës duhet të jetë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, demokracisë dhe ligjit ndërkombëtar dhe të kontribuojë në sigurinë rajonale". Për të mundur këtë ne ju nxitim që të: Siguroni një bilanc të gjinive, në të gjitha nivelet, në zyrën tuaj në Vjenë; Siguroni se gratë dhe organizatat e grave në rajon të marrin pjesë në mënyrë të barabartë dhe të plotë në bisedimet për status; Siguroni se situata e grave dhe roli i tyre i drejtë i barabartë në proceset e paqes dhe demokracisë të bëhet i dukshëm për akterët e ndryshëm të përfshirë në bisedimet për status; Siguroni se të gjithë akterët e përfshirë në implementimin e standardeve të respektojnë obligimet e tyre sipas 1325 dhe të marrin parasysh situatën e grave dhe vajzave dhe të forcojnë të drejtat njerëzore të grave.

Ka shumë gra dhe organizata të grave të fuqishme në Kosovë dhe në Serbi të cilat për shumë vite kanë qenë në vijën e parë të ndërtimit të paqes. Ato kanë një rolë vendimtar për të ardhmen e Kosovës dhe të rajonit si tërësi. Pjesëmarrja e tyre është parakusht për demokraci. Përfshirja e tyre do të ishte një humbje e madhe për të gjithë në Kosovë dhe Serbi. Presim reagimin tuaj në lidhje me këto çështje.

Sinqerisht, Kerstin Grebäck, Sekretare e Përgjithshme, Fondacioni Kvinna till Kvinna

Njoftime të Shkurtëra

Çdo vit studentët nga European Inter-University Centre për të Drejtat e Njeriut dhe Demokrati-zimin, i themeluar në Venedik, bashkëpunojnë me studentët e Universitetit të Prishtinës për të vizituar institucionet kosovare si dhe RRGKK-në. Me 14 janar 2006 ata u takuan me përfaqësueset e RRGKK-së në Qendrën Informativë Humanitare ku diskutuan për gjendjen momentale të gruas në politikë dhe statusin e saj në Kosovë.

Në dhjetor 2005, USAID ftoi të gjithë ata që morën pjesë në Programin Trajnues të Pjesëmarrjes (PTP). Të shpërblyerit përfshinin përfaqësuesit nga qeveria dhe shoqëria civile. Përfaqësueset e RRGKK-së u shpërblyen gjithashtu



Kryeministri Bajram Kosumi, Shefi i Misionit Amerikan Phillip Goldberg, dhe Drejtori i USAID Ken Yamashita përgëzojnë përfaqësueset e RRGKK-së.

PTP "Fuqizimi dhe Avokimi i Kapaciteteve të RRGKK-së"